



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 29 Janar 2022

Nr: 10

V E N D I M

P Ë R

**PËRDORIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË VOTUESVE NË
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, neneve 14, pika 2, 20, pika 1, shkronja “ë” dhe 22, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) që janë përdorur në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në të gjithë qendrat e votimit në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO -	Kryetare
Arens ÇELA -	Anëtar
Dritan ÇAKA -	Anëtar
Helga VUKAJ -	Anëtare
Muharrem ÇAKAJ -	Anëtar

